



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike, Kompania Rajonale e Ujitjes Drini i Bardhë Sh. A. Pejë, emëron këta kandidatë:
 - Znj. Arjeta Zeka, kryesuese;
 - Z. Ilaz Halili, anëtar;
 - Z. Shkodran Gaxherri, anëtar;
 - Znj. Zamire Deçani-Beqiri, anëtare;
 - Znj. Rina Sylafeta-Kumnova, anëtare;
 - Z. Besim Kajabegolli, anëtar.
- Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
- Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë